



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 101, datë 29.07.2020**

**PËR  
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE NË SHOQËRINË E SIGURIMIT  
“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 48, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit të ri, shoqërisë “UNIQA Osterreich Versicherungen AG”, në nivelin 86.93% në kapitalin e shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., si aksionar influencues.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**